



REPUBLIKA E SHQIPERISE
 GJYKATA E RRETHITGJYQESOR ELBASAN
 NR.REGJ.THEMELTAR -516- (61002-01796-13)
 NR.VENDIMIT -516- (13-2013-4836)

V E N D I M
 “NE EMER TE REPUBLIKES “

Gjykata e Rrethit gjyqesor Elbasan e perbere nga:

Gjyqtare : PAJTIME FETAHU,

asistuar prej sekretares **Alketa Çerekja**, ne Elbasan, sot ne date **16.08.2013**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore kerkesen e paraqitur nga:

K E R K U E S E : Prokuroria e Rrethit Elbasan, perfaqesuar ne gjykim nga **prokurori Kreshnik Ajazi**.

OBJEKTI: Vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive.

BAZA LIGJORE: Neni 274 e vijues te K.Pr. Penale.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor, pas administrimit te provave shkresore, prokurori ne konkluzionet perfundimtare *kerkoi pranimin e kerkeses*.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe bisedoi çeshtjen,

V E R E N:

Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Elbasan ka paraqitur prane kesaj gjykate, kerkesen per vendosjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros Preventive mbi dampat e shllamës se hekurit te ndodhura ne Paper te Elbasanit dhe ne kombinatin Metalurgjik Elbasan.

Shqyrtimi gjyqesor provoi se:

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan është referuar një material kallëzues nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan, mbi bazen e te cilit eshte regjistruar procedimi penal Nr. 1320, viti 2013, per veprat penale te parashikuara nga nenet 134 dhe 320 te K.Penal.

transportimin e "Shllambes se Hekurit" nga Papri per ne sheshpushimin tjeter ne Metalurgji Elbasan...".

Ne funksion te hetimeve, ne date 02.08.2013, eshte paraqitur ne Drejtorine e Policise Qarkut Elbasan shtetasi Aleksander Binjaku, i cili eshte administrator i shoqerise "Heidorn & Binjaku" shpk, i cili eshte pyetur si person qe ka dieni per vepren penale dhe ne deklarimet e tij ne kete cilesi, ka spjeguar se: " me date 17.11.2010 shoqeria e tij kishte fituar lejen minerare per shfrytezimin ne objektin e Shllambave te hekurit te kombinatit metalurgjik "Paper Elbasan", ka ka marre lejen Nr.1514. Shtetasi Aleksander spjeron se brenda afatit shoqeria e tij ka filluar investimet e planifikuara dhe jane tejkeluar investimet. Me date 06.08.2012 shoqeria e tij eshte njoftuar nga METE per fillimin procedurave per revokimin e lejes minerare Nr.1514, ju jane njoftuar institucionet e tjera si D.R.Doganore Durrës; D.R.T.Elbasan dhe Drejtoria Policise Qarkut Elbasan. Ne te njejten kohe shoqeria Heidorn Binjaku ka kerkuar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, me ane te nje padie, anullimin e urdherit te Ministrit te Ekonomise per anullimin e lejes Nr.1514 dhe anullimin e procedurave te nxjerrjes ne ankand te "Dampes se Paprit". Shtetasi Aleksander Binjaku spjeron se edhe pse kane gene ne proces gjyqesor, METE ka organizuar ankandin dha ka shpallur fitues shoqerine "KEDO" shpk...".

Me vendimin Nr.6169, date 04.04.2013 Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ka vendosur: - *Te pezulloje ekzekutimin e aktit administrativ per shpaljen e fituesit te ankandit Nr.9199/31, date 19.12.2012 te METE qe i perket shoqerise "KEDO" shpk Fier, konkretisht duke mos u realizuar lidhje e kontrates midis ketyre dy paleve deri ne perfundim te shqyrtimit gjyqesore te kesa ceshtje.*

Ne deklarimet e tij shtetasi Aleksander Binjaku spjeron se kete vendim ia ka derguar METE me shkrese Nr.3542/2, date 26.04.2013.

Ai spjeron gjithashtu se shoqeria "Kedo" shpk me sa ka dijeni ka 45% te aksioneve ne shoqerine "Malberg" shpk e cila ka nje kontrate me METE per blerjen e shllames se hekurit ne Damen e Paprit ne Ebasan dhe brenda 180 diteve duhet te paguante te gjithe shumen e vleres se kontrates ne METE, gje e cila nuk eshte bere. Gjithashtu shoqeria Malberg duhet te paraqiste nje plan shfrytezimi te miratuar nga METE, qe te paisej me leje shfrytezimi dhe leje mjedisore, te cilat subjekti Malberg nuk i ka. Edhe pse shoqeria "Kedo" eshte njoftuar per vendimin e Gjykates Nr.6169, date 04.04.2013 vazhdon te shfrytezoj minerarin Shllam Hekuri ne zonat e lejeve Nr.1514 dhe Nr.1563, te cilat jane te subjekteve Heidorn & Binjaku dhe Anti -Avis".

Sipas shkreses Nr.3275/5, date 18.06.2013 te Agjensise Kombetare te Burimeve Natyrore, rezulton se kjo e fundit me ane e nje grupi pune ne daten 11.06.2013 ka ushtruar kontroll ne objektet e ish lejes minerare nr.1514 dhe 1563, nga i cili ka rezultuar se ne te dyja objektet minerare punohet nga persona te palicensuar.

Vendimi ka marre forme te prere me date 26.08.2013.
Me shkresen Nr.516 date 28.08.2013 vendimi ju dergua organit te
prokurorise se Rrethit Elbasan.

K/SEKRETARI
Shaban DEDJA



KANCELARE
Merita DURO



Gjykata e Rrethit Gjyqësor
Elbasan
Vërtetohet se ky akt është i njëjtë
me origjinalin që ndodhet në
arkiv. Dt. 23/11/2013